



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Seancë plenare e Kuvendit

P- 047

Prishtinë, më 20 nëntor 2008, në orën 10:0

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 20 NËNTOR 2008

Seancën e drejtoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 81 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 6, 7 dhe 10 nëntor 2008,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje nga rrezatimi jo jonizues, dhe jonizues dhe siguria nukleare,
4. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për ngrohjen qendrore, nr. 02/L-049,
5. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për procedurën jo kontesimore, nr.03/L-007,

6. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për avokatinë, nr. 02/L- 040,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për inspeksionin bujqësor,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për akreditim,
9. Shqyrtimi i rekomandimit Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës,
10. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 02/L-74 për revizionin e brendshëm,
11. Shqyrtimi i Raportit lidhur me gjendjen mjedisore për periudhën 2006-2007, dhe
12. Njoftimi i Grupit Parlamentar të PDK-së për ndërrimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare.

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 6, 7 dhe 10 nëntor 2008

Kuvendi miratoi pa vërejtje procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 6, 7 dhe 10 nëntor 2008.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Driton Tali**, i parashtoi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe Financave lidhur me privatizimin e Ndërmarrjes “Ballkani” – **Fabrika e Gomave**.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputeti **Riza Smaka**, e lexoi pyetjen, për ministrin e Punëve të Brendshme, lidhur inkasimin e taksës plotësuese për sigurimin e mjeteve motorike nga qytetarët e Kosovës, të cilët punojnë përkohësisht në botën e jashtme.

Deputetja **Suzan Novobrdaliu** i parashtoi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, lidhur përdorimin e drogës në shkollat e mesme.

Ministri **Zenun Pajaziti** iu përgjigj pyetjes së deputetes Novobrdaliu.

Deputeti **Riza Smaka**, i parashtoi pyetje ministrit të Shëndetësisë, lidhur shërbimet shëndetësore sekondare që ushtrohen në Qendrën Klinike Universitare.

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Smaka**.

Deputetja **Myrvete Pantina**, i parashtoi pyetje ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, lidhur me çmimet e larta të plehrave, farës së grurit dhe karburanteve.

Ministri **Idriz Vehapi** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Pantina**.

Deputeti, **Emrush Xhemajli**, i parashtoi pyetje ministrit të Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, lidhur me ndotjen e ambientit nga materiet e rrezikshme.

Ministri **Mahir Yagcillar** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Xhemajli**.

Deputetja **Donika Kada-Bujupi**, i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, lidhur me mbylljen e universiteteve private.

Ministri **Enver Hoxhaj** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Kada-Bujupi**.

Deputeti, **Enis Kervan** i parashtroi pyetje ministrit të Shërbimeve Publike, lidhur me përdorimin e gjuhës turke.

Ministri **Arsim Bajrami** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Krvan**.

Deputeti **Naser Rugova** i parashtroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, lidhur me gjendjen sociale të minatorëve të ish-kombinatit “Trepça”.

Ministri **Nenad Rashiq** iu përgjigj pyetjes së deputetit Rugova.

Deputeti **Nait Hasani** i parashtroi pyetje ministrit të Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor dhe ministrit të Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, lidhur me **prerjen e pyjeve** në Malet e Sharrit.

Ministrat **Mahir Yagcilar** dhe ministri i Punëve të Brendshme **Zenun Pajaziti** iu përgjigjen pyetjes së deputetit Hasani.

Deputetja **Gjylnaze Syla** i parashtroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, lidhur me shkallën e papunësisë në Kosovë.

Ministri **Nenad Rashiq** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Syla**.

Deputetja **Teuta Hadri** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, lidhur me funksionimin e Repartit të Lehonave në Qendrën Klinike Universitare.

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Hadri**.

Deputetja **Kaqusha Jashari** i parashtroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, lidhur me hartimin e Ligjit për sigurimin pensional e invalidor.

Ministri **Nenad Rashiq** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Jashari**.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje nga rrezatimi jo jonizues, jonizues dhe siguri nukleare

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, **Mahir Yagcilar**, tha se qëllimi i këtij projektligji është krijimi i kornizës ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit nga rrezatimi jo jonizues, jonizues dhe siguria nukleare në Kosovë, si dhe nevoja e harmonizimit të legjislacionit mjedisor me atë të Bashkësisë Evropiane.

Projektligji për mbrojtjen nga rrezatimi jo jonizues, jonizues dhe siguria nukleare përbëhet nga 62 nene dhe i trajton çështjet, si në vijim:

Mbrojtjen nga rrezatimi jo jonizues dhe jonizues, ku trajtohet sistemi i masave të mbrojtjes nga rrezatimi jo jonizues dhe jonizues,

Hulumtimin sistematik të përmbajtjes së nuklideve në mjedis, vlerësimin e nivelit të ekspozimit dhe të rrezatimit jo jonizues dhe jonizues dhe kushtet për operim të rrezatimit, Obligimet e personave fizik dhe juridik të cilët prodhojnë, bëjnë bartjen dhe shfrytëzojnë burimet e rrezatimit jonizues,

Ndalimin që të punohet në burimet e rrezatimit jonizues të disa kategorive të personave, siç janë gratë shtatzëna dhe personat nën 18 vjeç,

Menaxhimin me mbeturinat radioaktive dhe deponimi i përkohshëm dhe i përhershëm i mbeturinave radioaktive.

Projektligji është në harmoni të plotë me legjislacionin e BE-së.

Në vazhdim, seancën e kryesoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryesuesi, e hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për mbrojtje nga rrezatimi jo jonizues, jonizues dhe siguri nukleare.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për mbrojtje nga rrezatimi jo jonizues, jonizues dhe siguri nukleare dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Berat Luzha**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Heset Cakolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Zylfije Hundozi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Naser Rugova**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Shpresa Murati**, si dhe deputetët: **Gjylnaze Syla**, **Riza Smaka**, **Ardian Gjini** dhe **Mimoza Ahmeti**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbal.

Në fund të diskutimeve, lidhur më vërejtjet e dhëna nga deputetët, u përgjigj ministri Mahir Yagcilar.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 63,
Kundër----- 3,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për mbrojtje nga rrezatimi jo jonizues, jonizues dhe siguri nukleare.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor – si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion e Gjyqësi, Komisionin për Buxhet e Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për ngrohjen qendrore, nr. 02/L-049

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit funksional që ta arsyetojë rekomandimin.

Kryetarja e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, **Myzejene Selmani**, tha se Komisioni në bazë të vendimit të Kuvendit, ka shqyrtuar Ligjin për ngrohje qendrore, i cili nuk është shpallur nga PSSP-ja. Komisioni ka hartuar amendamente, me të cilat është harmonizuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe i rekomandon Kuvendit që ta miratojë Ligjin për ngrohje qendrore me amendamentet e propozuara.

Kryesuesi i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Kuvendi miratoi amendamentet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Ligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----64,
Kundër----- 0,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për ngrohjen qendrore.

5. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për procedurën Jo kontestimore

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit funksional që ta arsyetojë rekomandimin.

Bahri Hyseni tha se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me vendimin e Kuvendit, ka shqyrtuar Ligjin për procedurën jo kontestimore, i cili nuk është shpallur nga PSSP-ja dhe ka hartuar amendamente, me qëllim të harmonizimit të tij me Kushtetutën e Kosovës. Komisioni i rekomandon Kuvendit që ta miratojë Ligjin për procedurën jo kontestimore me amendamentet e propozuara.

Kryesuesi i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Kuvendi miratoi amendamentet 1 dhe 2.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Ligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----60,
Kundër----- 0,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për procedurën jo kontestimore.

6. Shqyrtimi i rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për Avokatinë

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit funksional që ta arsyetojë rekomandimin.

Bahri Hyseni tha se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka shqyrtuar Ligjin për avokatinë, i cili nuk është shpallur nga PSSP-ja dhe ka hartuar amendamente me qëllim të harmonizimit të tij me Kushtetutën e Kosovës. Komisioni i rekomandon Kuvendit që ta miratojë Ligjin për avokatinë me amendamentet e propozuara.

Kryesuesi i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Kuvendi miratoi amendamentet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, dhe 23.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Ligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----68,
Kundër----- 0,
Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për avokatinë.

7. Shqyrtimi dytë i Projektligjit për Inspeksionin bujqësor

Kryesuesi i informoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe me raportet e komisioneve të përhershme parlamentare dhe të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor, si komision përgjegjës dhe raportues.

Kryesuesi hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 74;
Kundër----- 0.
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për Inspeksionin bujqësor.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për akreditim

Kryesuesi i informoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe raportet e komisioneve të përhershme parlamentare dhe të Komisionit për Ekonomi, Tregti Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si Komision përgjegjës dhe raportues.

Kryesuesi hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 69;
Kundër----- 0.
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për akreditim.

9. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës dhe debati për gjendjen në Trustin Pensional

Kryesuesi i informoi deputetët, se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2008, me kërkesë të 2 grupeve të deputetëve ka kërkuar nga Qeveria që të përgatitë një informatë lidhur me gjendjen në Trustin Pensional të Kosovës.

Kryesia, në mbledhjen e mbajtur më 18 nëntor 2008, ka ripërsëritur kërkesën dhe ka kërkuar nga Kryeministri që për seancën e sotme plenare të përgatitë informatën për deputetët e Kuvendit.

Lus zëvendëskryeministrin, Hajredin Kuçi, nëse ka diçka për të thënë lidhur me këtë, sepse Kuvendi nuk ka informatë me shkrim.

Zëvendëskryeministri, **Hajredin Kuçi**, tha se Kryesia e Kuvendit, respektivisht Kabineti i Kryetarit ka një marrëveshje me guvernatorin apo udhëheqësin e Bankës Qendrore, që të vijë dhe ta prezantojë para Kuvendit çështjen e Trustit.

Kryesuesi, kërkoi nga deputetët që të deklarojnë lidhur me propozimin e Qeverisë për shtyrjen e debatit për gjendjen në Trustin Pensional dhe emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi propozimin e Qeverisë për shtyrjen e debatit për gjendjen në Trustin Pensional dhe rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës dhe debatin për gjendjen në Trustin Pensional.

10. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për raportin e Grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 02/L74 për revizionin e brendshëm

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit për Buxhet e Financa që ta arsyetojë rekomandimin.

Kryetari i Komisionit, **Gani Koci**, tha se Komisioni për Buxhet e Financa ka formuar Grupin Punues për mbikëqyrjen e implementimit të Ligjit për auditimin e brendshëm, andaj, në emër të Komisionit, Raportin e arsyeton deputeti Armend Zemaj.

Armend Zemaj, tha se në pajtim me Rregullën 53 të Rregullores së Punës së Kuvendit Komisioni për Buxhet e Financa, ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për auditimin e brendshëm.

Komisioni në bazë të hulumtimit që ka bërë për zbatimin e Ligjit për auditimin e brendshëm ka identifikuar 18 probleme, të cilat duhen të zgjidhen.

Andaj, Komisioni ia paraqet Kuvendit këto

REKOMANDIME:

1. Qeveria, përkatësisht, Ministria për Ekonomi dhe Financa duhet, që në afatin sa më të shkurtër, të ndërmarrë masa të nevojshme për themelimin dhe funksionimin e njësive të auditimit dhe të komiteteve të auditimit nëpër të gjitha organizatat buxhetore.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave, përkatësisht Njësia Qendrore për Harmonizim, duhet të ketë bashkëpunim me të gjitha organizatat buxhetore.
3. Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe NJQH duhet të ndikojë tek organizatat buxhetore që rekomandimet e Auditorit të Brendshëm të merren parasysh dhe të implementohen.
4. Qeveria, përkatësisht Ministria për Ekonomi dhe Financa duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar pavarësinë e auditorëve, në përputhje me Ligjin për auditimin e brendshëm.
5. Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe NJQH duhet t'i nxjerrin në afatin sa më të shkurtër aktet nënligjore dhe rregulla të tjera në përputhje me Ligjin për auditimin e brendshëm, neni 6, pika 4.
6. Ministria për Ekonomi dhe Financa, përkatësisht Njësia Qendrore për Harmonizim, duhet t'i ndërmarrë masat e nevojshme që organizatat buxhetore t'i përmirësojnë kushtet e punës së Auditorit të Brendshëm.
7. Ministria për Ekonomi dhe Financa duhet t'i ndërmarrë masat e nevojshme që organizatat buxhetore t'u lejojnë auditorëve të brendshëm qasjet e pakufizuara në dokumentet zyrtare.
8. Ministria e Ekonomisë dhe Financave duhet të ndikojë te organizatat buxhetore që të zgjedhen drejtorët e njësive të auditimit të brendshëm në bazë të ligjit. Gjithashtu,

Ministria duhet të sigurohet që pagesa e drejtorëve në njësitë e auditimit të bëhet në bazë të ligjit.

9. Ministria për Ekonomi dhe Financa duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për të penguar dhe larguar konfliktin e interesit tek auditorët e brendshëm dhe anëtarët e Komitetit të Auditimit.

10. Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, në afatin sa më të shkurtër duhet të paraqesë në Kuvend raportin vjetor për funksionimin e auditimit të brendshëm. Qeveria duhet të ndërmarrë masa në zbatimin e Ligjit për auditimin e brendshëm brenda njësive të veta, e sidomos nëpër ministri. Duhet të krijohen raporte bashkëvepruese ndërmjet Njesisë Qendrore për Harmonizim me Auditorin e Përgjithshëm.

11. Ministria e Ekonomisë dhe Financave duhet t'i raportojë Komisionit për Buxhet dhe Financa për nivelin e zbatimit, të ligjeve së paku një herë në vit.

Kryesuesi hapi debatin lidhur me rekomandimin e Komisionit për Buxhet e Financa.

Opinionet lidhur me Rekomandimet e Komisionit për Buxhet e Financa i dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramë Buja**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Naim Maloku**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Besa Gaxherri**, në emër të Grupit Parlamentar "7+", **Enis Kervan**, në emër të Grupit Parlamentar SLS, **Kosara Nikoliq**, si dhe deputetët **Riza Smaka**, **Gani Koci**, **Gjylnaze Sylja**, **Bahri Hyseni**, **Edita Tahiri**, **Kaqusha Jashari**, **Gani Geci**, **Berim Ramosaj**, **Gani Buçinca** dhe në emër të Qeverisë zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Në vazhdim seancën e drejtoi , **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari i hodhi në votim rekomandimet e Komisionit për Buxhet e Financa. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----63;

Kundër-----0;

Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V e n d i m

1. Miratohen rekomandimet e Komisionit për Buxhet e Financa, lidhur me zbatimin e Ligjit për auditimin e brendshëm.
2. Ngarkohet Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Ekonomisë dhe e Financave për implementimin e rekomandimeve të miratuara.

11. Shqyrtimi i Raportit lidhur me gjendjen mjedisore për periudhën 2006-2007

Kryetari i informoi deputetët se Qeveria, në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e mjedisit ia ka paraqitur Kuvendit Raportin lidhur me gjendjen mjedisore për periudhën 2006-2007.

Komisioni Funkcional për Bujqësi dhe Mjedis ka shqyrtuar Raportin dhe ka rekomanduar që të shqyrtohet në seancë plenare.

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta arsyetojë raportin.

Ministri i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, **Mahir Yagcilar** e arsyetoi Raportin për gjendjen mjedisore për periudhën 2006-2007.

Diskutimi i ministrit **Mahir Yagcilar**, është dhënë në transkript që është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Kryetari ftoi kryetarin e Komisionit funksional për Bujqësi, Mjedis e Planifikim Hapësinor, **Lulzim Zeneli** që të paraqesë qëndrimin e Komisionit lidhur me Raportin për gjendjen mjedisore për periudhën 2006-2007.

Kryetari i Komisionit Funkcional, **Lulzim Zeneli**, e paraqiti qëndrimin e Komisionit dhe të Grupit Parlamentar të LDD-së, lidhur me Raportin për gjendjen mjedisore për periudhën 2006-2007.

Diskutimi i kryetarit të Komisionit Funkcional, **Lulzim Zeneli**, është dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Opinionet lidhur me Raportin për gjendjen mjedisore për periudhën 2006-2007 i dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Selvije Halimi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ahmet Isufi**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Müferra Şinik**, si dhe deputetët: **Berat Luzha**, **Gani Geci**, **Driton Tali**, **Muzejene Selmani**, **Njomza Emini**, **Riza Smaka**, **Heset Cakolli**, **Ramadan Avdiu**, **Ardian Gjini**, **Myrvete Pantina**, **Hajdin Abazi**, **Gani Buçinca**, **Nurishahe Hulaj** dhe **Elheme Hetemi**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Në fund të diskutimeve, në vërejtjet e dhëna nga deputetët, u përgjigj ministri **Mahir Yagcilar**.

Përgjigjja e ministrit **Mahir Yagcilar**, është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Kryetari i hodhi në votim Raportin lidhur me gjendjen mjedisore për periudhën 2006-2007. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----42;

Kundër-----16;

Abstenime----- 4.

Kryetari, konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V e n d i m

1. Miratohen Raportit lidhur me gjendjen mjedisore për periudhën 2006-2007, me vërejtjet e dhëna.

12. Njoftimi i Grupit Parlamentar të PDK-së për ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryetari i njoftoi deputetët me propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së, që ka vendosur për ndërrimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare, si vijon:

Në Komisionin për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, Kulturë, Rin e Sport emërohet deputeti **Gani Buçinca**, në vend të deputetes **Vlora Çitaku**. Gjithashtu, në Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media emërohet deputeti **Hajredin Hyseni**, në vend të deputetit **Gani Buçinca**.

Deputeti **Emrush Xhemajli**, emërohet zëvendëskryetar i parë i Komisionit për Shërbime Publike, në vend të deputetit Fehmi Mujota.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 15:50 minuta

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:
Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale